



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-12282
Kaçanik, 25.06.2025

PROCESVERBAL i KONSULTIMIT PUBLIK-Me qytetarë për draft Kornizën
Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal
13.06.2025 ora 14.00

Të pranishëm në debat nga ekzekutivi komunal:

Kryetari i Komunës Besim Ilazi

Nënkryetari Sabedin Vishi

Drejtori për Buxhet dhe Financa Bahri Selimi

Drejtoresha për Administratë të Përgjithshme Dardana Dauti

Drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Suhad Dullovi

Drejtori për Shëndetësi Sali Malsiu

Takimin e hapi Kryetari i Komunës Besim Ilazi, i cili tha se me qëllim të rritjes së transparencës po e organizojmë këtë takim publik, ndërsa shtoi se edhe më tutje si institucione komunale vazhdojmë të ballafaqohemi me sfida nga mos përkrahja e nivelit qendror si dhe me pasojat e kontratës kolektive që po dëmtohet buxheti komunal.

Nënkryetari i Komunës Sabedin Vishi shpalosi detaje nga ky dokument buxhetor, duke shtuar se buxheti për vitin e ardhshëm do të jetë afër 13 milion e 169 mijë euro, ndërsa për investime kapitale do të ndahen 2 milion e 829 mijë euro, ku parashihen investime në Administratë publike, shërbime publike, si rrugë, kanalizime, trotuare e ujësjellës, mirëqenie sociale, shëndetësi, arsim, turizëm e zhvillim ekonomik si dhe bujqësi e ambient. Të pranishmit në debat poashtu ishin të pajisur me materiale të nevojshme nga drejtoria e financave.

Ndërsa nga të pranishmit u shtruan kërkesat si vijon:

Nexhmedin Lika: Të rregullohet rrethoja e objektit shkollor në këtë fshat.

Azem Koraqi- Rregullimi i një korite të re të kanalizimit, ky projekt është largu dhe është zëvendësu me një projekt tjetër po në këtë fshat. Poashtu janë disa përroska që duhet të pastrohen.

Kadri Dardhishta- Kërkoj që të rregullohet rruga " Emin Duraku" në Llanishtë

Rruga " Azem Vokshi" të rregullohet kanalizimi

Hasip Saliu- Të rregullohet rruga Bajnicë- Semajë- si dhe të pastrohen përroskat sepse po rrezikojnë ujësjellësin.

Naser Murseli- Lagjja Leka të lidhet Mulliri deri tek rruga Dallosh, vetëm të bëhet zgjerimi i rrugës me zhavorr.

Për të gjitha kërkesat u dhanë përgjigjet nga ana e ekzekutivit komunal, ndërsa për secilën kërkesë janë dhënë edhe përgjigjet me shkrim në raportin e dëgjimeve publike për KABK.

Procesmbajtëse:

Eni Hume Guri Selimi

